

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË HIMARË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Himarë me objekt: “Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, etj” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 820 datë 31.12.2012. Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 820/10, datë 31.12.2012 , dërguar z. **Jorgo GORO**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga Këshilli i Bashkisë dhe Kryetari i saj të merren në analizë rezultatet e auditimit të KLSH-së, të hartohet program masash brenda afatit ligjor, për realizimin e rekomandimeve.

Brenda muajit Janar 2013

2. Nga Bashkia Himarë të zbatohen detyrat dhe rekomandimet e auditimit të KLSH-së dërguar me shkresën nr. 372/6, datë 29.3.2010, rikërkuar me shkresën nr. 372/17, datë 22.10.2010 dhe të kontabilizohen e kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i dëmit të shkaktuar buxhetit të shtetit nga keqmenaxhimi i Njësisë, në vlerën prej **22,235,224 lekë**, (për 11 masa zhdëmtuese dhe administrative).

Brenda muajit Qershor 2013

3. Nga drejtuesit e Bashkisë Himarë të hartohet plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar, plani strategjik, të përcaktohen objektivat dhe hartohen plan veprimet afatshkurta në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Brenda muajit Shkurt 2013

4. Të hartohet strategjia e zhvillimit ekonomik dhe sektorial nga Bashkia Himarë dhe të ngrihen ekipet përkatëse të menaxhimit, si dhe të merren në konsideratë objektivat e vendosura në hartimin e projekt buxhetit, te vitit në vijim në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxheto”.

Vazhdimisht

5. Nga Drejtoria Ekonomike të sigurohet evidentim i saktë dhe të kryhet zbatim uniform si për buxhetin vendor dhe atë qendror, në zbatim të ligjit nr. 10190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", i ndryshuar dhe ligjin nr. 10355, datë 02.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”.

Vazhdimisht

6. Të nënshkruhet Akt-Marrëveshja Tip “Për realizimin e Shërbimit të Auditimit të Brendshëm”, ndërmjet Bashkisë dhe Prefektit të Qarkut Vlorë, bazuar në ligjin nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar, dhe në udhëzimin e NjQHAB nr. 12, datë 5.6.2012 “Mbi Procedurat e Kryerjes së Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Brenda muajit Mars 2013

7. Nga Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Tatim Taksave të bëhen kontabilizimet për debitorët nga tatime taksat dhe të zbatohen procedurat tatimore për arkëtimim e detyrimeve të pambledhura në shumën totale **87,783,240 lekë**, nga e cila; taksë nga ndërtesat 5,001,120 lekë, taksë për tokën 9,271,000 lekë, taksë hoteli 8,242,000 lekë, taksë për zënie hapësire publike 65,269,120 lekë.

Brenda muajit Qershor 2013

8. Nga Drejtoria e Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DMMT) dhe Drejtoria Ekonomike të bëhet inventarizimi, marrja nën administrim, zbatimi i planeve ekzistuese të menaxhimit, hartimi i planeve të reja të sipërfaqeve pyje-kullotave-gjendje, të 10 monumentet natyrore

të përfshira në juridiksionin e Bashkisë sipas VKM nr. 676, datë 20.12.2002 dhe për 916,1 ha të transferuara si dhe të destinohen në buxhet, sipas destinacionit të paracaktuar ligjor,

burimet në vlerën prej 9,020 mijë lekë si të ardhura të krijuara nga përdorimi i tyre, e të përdoren për hartimin dhe zbatimin e planeve të menaxhimit e mbarështimit të pyje-kullotave.

Brenda muajit Mars 2013 e në vazhdim

9. Nga DMMT të kryhet inventarizimi kadastral i fondit pyjor me synim evidencimin përditësimin e përdorimin e fuqisë lëndore, fuqisë kullimore, bimore, aftësisë së funksionit mbrojtës (për pyjet mbrojtës) dhe të bëhet mbajtja, evidentimi, administrimi e balancimi i fondit kullor.

Brenda muajit Qershor 2013

10. Nga DMMT të bëhet dhe mbahet bilanci i fondit të tokës për sipërfaqen në tërësi, ndarë në fondin e tokës bujqësore (ku evidentohen 2171 ha), fondin e tokës së zënë me pyje, fondin e tokës së zënë me kullota e livadhe dhe fondin e tokës-truall si dhe të pasqyrohen ndryshimet në kategori të resurseve. Gjithashtu të bëhet bilanci sipas formës së qeverimit, i fondit të tokës sipas kategorive.

Brenda muajit Qershor 2013

11. Nga DMMT dhe Drejtoria Ekonomike të kryhet inventarizimi fizik, të përfshihen në inventarin kontabël dhe librin e AQT-ve pasuritë ndërtimore, pjesë përbërëse të resurseve që lidhen me infrastrukturën e mobilimit të tokës për kategoritë: pyje, objektet "Prita Malore"; kategorinë kullota livadhe, objektet ndërtimore si lerat e pirjes së ujit të bagëtive; për kategorinë tokë bujqësore objektet si ujëmbledhësit dhe infrastruktura ujitëse, rrjeti i kanalizimeve ujitëse dhe rrjeti i kanalizimeve të ujërave të larta, pritat, sifonet.

Brenda Shtator 2013

12. Nga Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Urbanistikës dhe Drejtoria Ekonomike të kryhet inventarizimi fizik, të përfshihen në inventarin kontabël dhe librin e AQT-ve pasuritë ndërtimore, të evidentohet e raportohet gjendja aktuale fizike dhe të vihen në efikasitet 55 pronat e paluajtshme (Asete) sipas listës përcaktuar në VKM nr. 101, datë 20.2.2003 dhe tabelës e trajtuar analitikisht në procesverbalin nr. 31, datë 31.10.2012.

Brenda Mars 2013

13. Të kryhet regjistrimi i 35 pasuritë pyjore në ZVRPP dhe të dorëzohen e administrohen në arshivë certifikatat ose vërtetimet e pronësisë sipas ligjit "Për Arkivat".

Qershor 2013

14. Nga Bashkia të rishikohet struktura organizative dhe të përfshihen specialist të arsimuar në drejtimin “Inxhinier për Mbarëshkrimin e Pyjeve” në funksionin e menaxherit në DMMT dhe në funksionin e Policisë Pyjorë në Policinë Bashkiake, *trajtuar në faqe 177 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*

Brenda Shkurtit 2013

15. Nga Bashkia të rishikohet dhe të përfshihen në Rregullore dhe në “Përshkrimin e vendit të punës”, detyrimi ndaj DMMT (Për administrimin e aseteve tokë, pyje, kullota, livadhe, monumente natyrore infrastrukturat përkatëse ujitëse kulluese me aksesoret e tyre, mobiluese të tokës etj), dhe ndaj Drejtorisë Shërbimeve (Për administrimin e aseteve troje, ndërtesa social kulturore, sheshe sipërfaqe të gjelbëruara, sisteme kanalizimesh, sisteme ndriçimi, sisteme të ujit të pijshëm, monumente kulturore dhe historike, vend strehime të nëndheshme dhe çdo infrastrukturë urbanistike ndodhur në fshatra e qytet etj.

Brenda Majit 2013

16. Nga Zyra e Protokoll-Arkivës të administrohet dhe inventarizohen, gjithë dokumentacioni zyrtar i drejtorive përkatëse i pa administruar aktualisht, në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Brenda Prillit 2013

17. Nga Bashkia Himarë, të plotësohen dosjet e personelit me dokumentacioni përkatës, dhe të lidhen kontratat e punës me punonjësit e administratës, në zbatim të VKM nr. 355, datë 07.07.2000 “Për organizimin e dosjes së regjistrimit të personelit”.

Brenda Marsit 2013

18. Bashkia Himarë, të marrë masa e të verë në funksionim mbajtjen e kontabilitetit sipas programeve të IT, të zbatohet limitin e arkës për ruajtjen e mjeteve monetare, të kryej regjistrimet lidhur me lëvizjen e aktiveve në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM nr. 290, datë 14.06.1993 “Për limitin e arkës në ndërmarrjet shtetërore”.

Qershor 2013

19. Nga Bashkia Himarë, të programohen pagat dhe sigurimet shoqërore nga të ardhurat dhe nga grandit, fondi i veçantë, për dhënien e ndihmes së menjëhershme financiare të kërkojë plotësimin e dokumentacionit përkatës, në zbatim të nenit 54 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe VKM nr. 1151, datë 25.11.2009 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar.

Vazhdimisht

20. Nga Bashkia Himarë, të hartohet regjistri i parashikimit të prokurimeve publike dhe dokumentacionin e blerjeve me vlera të vogla ta plotësojë sipas kërkesave të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të mbaj regjistrin e ndihmave nga donacionet e ndryshëm, në zbatim të VKM nr. 166, datë 11.4.1997 “Për sigurimin dhe administrimin e ndihmave humanitare dhe të emergjencës”, të ndryshuar.

Vazhdimisht

21. Materialet e nxjerrja jashtë përdorimit nga Bashkia Himarë, të grumbullohen në magazinë me dokumentacion të rregullt, në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë **27.12.2011** “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Mars 2013

22. Nga Drejtoria Ekonomike të analizohet problemi i mosdokumentimit të dekorit të vitit 2010, në shumën 1,192,000 lekë, në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të kryhen veprimet kontabile përkatëse.

Mars 2013

23. Të mos pajisen me leje shfrytëzimi objektet e përfunduara, pa patur dokumentin e pronësisë si dhe gjithë dokumentacionin teknik, ndërsa për rastet kur ka ndryshim destinacioni, shtesa katesh apo sipërfaqe ndërtimore më tepër se sa miratimi nga KRRT-ja të mos jepen lejet e shfrytëzimit deri në momentin e përmirësimit të tyre, duke zbatuar sanksionet përkatëse.

Vazhdimisht

24. Nga ana e Drejtorisë së urbanistikës, para dhënies së lejes së shfrytëzimit të vlerësohen nga specialistët e saj aktkolaudimet e mbajtura nga specialistët e licencuar për objektet e përfunduara, në përputhje me kërkesat ligjore.

Vazhdimisht

25. Kërkesat e bëra nga qytetarët në lidhje marrje leje zhvillimi, të protokollohen duke adresuar me memo ndjekjen nga specialisti përkatës, të zbatohen afatet, adresimi për specialistët, verifikimi i dokumentacionit, etj. Të gjitha këto të jenë pjesë e inventarizimit dhe protokollimit të dosjeve.

Vazhdimisht

26. Të merren masa, të gjenden kontratat e munguara për dhënien me qera të sipërfaqeve kullimore dhe tokë bujqësore (të dhëna në të gjithë periudhën e audituar 2008-2011), si dhe të bëhet arkivimi i tyre sipas rregullave të përcaktuara në ligjin “Për arkivat” dhe të bëhet rivlerësimi faktik i tyre.

Deri në Mars 2013

27. Të merren masa për nënshkrimin e kontratës tip ndërmjet Bashkisë dhe personave fizik sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 4 datë 10.04.2008, për dhënien me qera të sipërfaqes së tokës për kullotë, duke ndjekur periodikisht arkëtimin e të ardhurave.

Vazhdimisht

28. Nga Bashkia Himarë, konkretisht nga DMMT të merren masa dhe të bëhet listimi dhe azhurnimi i të gjithë sipërfaqeve të dhëna me qera, duke hartuar regjistrin përkatës dhe ndjekur në mënyrë periodike të detyrimeve kontraktuale (Në regjistër të vendosen të gjithë treguesit e nevojshëm për vlerësimin e kontratës).

Deri në Mars 2013

29. Të merren masa për regjistrimin e kullotave dhe livadheve sipas Ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, dhe azhurnimi i ndryshimeve të pësuar, si dhe të bëhet inventarizimi i kullotave dhe livadheve sipas nenit 7, (kullotat dhe livadhet duhet të inventarizohen çdo 10 vjet.) të ligjit 9693 “Për fondin kullor”.

Deri në Mars 2013

30. Të merren masa për vendosjen e tarifave për mbledhjen e bimëve medicinale sipas llojit dhe sasisë, duke i përcaktuar me komision me specialistë.

31. Të merren masa, dhe të ndiqen procedurat ligjore dhe të gjithë hapat e trajtimit gjyqësor, për arkëtim e të ardhurave të paarkëtura si më poshtë:

Për vitin 2008:

Në kontratat me objekt dhënien me qira të kullotave dhe livadheve, të ardhurat e paarkëturat janë 53,250 lekë (*sipas Aneksit nr. 1 Pasqyra e llogaritjes së vlerës së kontratave të dhënies me qira për kullotje për vitin 2008*), ndërsa me objekt dhënien me qira të sipërfaqes së tokës për ushtrimin e veprimtarisë së biznesit me vlerë 1,149,250 lekë.

Deri në Mars 2013

Për vitin 2009

Në kontratat me objekt dhënien me qira të kullotave dhe livadheve, të ardhurat e paarkëturat janë 100,750 lekë (*sipas Aneksit nr. 2 Pasqyra e llogaritjes së vlerës së kontratave të dhënies me qira për kullotje për vitin 2009*). Të ardhura të cilat duhet të arkëtohen nga kjo bashki.

Deri në Mars 2013

Për vitin 2011

Në kontratat e lidhura me objekt dhënien me qira të kullotave dhe livadheve, të ardhurat e paarkëturat 792,000 lekë (*sipas Aneksit nr. 8 Pasqyra e llogaritjes së vlerës së kontratave për dhënien me qira për ushtrimin e biznesit vitin 2011*).

Deri në Mars 2013

32. Të merren masa për arkëtimin e të ardhurave me shoqëritë e telefonisë AMC sh.a dhe Vodafone sh.a si më poshtë:

Për periudhën 2008-2011 [REDACTED] sh.a 3,000,000 lekë

Për periudhën 2008-2011 [REDACTED] sh.a 184,592 lekë

Të ardhura të cilat duhet të arkëtohen nga kjo bashki.

Deri në Prill 2013

33. Bashkia Himarë të inventarizojë, përfshijë në fletë inventarizimi, dhe të denoncojë e kërkojë në Organet e Rendit paraqitjen fizike pranë baskisë të automjetit **Makinë e Transportit të Plehrave** me karakteristikat; Nisan TK 395 viti 2007, Shasi nr. VWHNGFTKO 64008320 me **vlerë 4,809,383 lekë** dhe të mjetit tip furgon i policisë bashkiake VL 2716 C me vlerë 1,057,305 lekë, në zbatim të ligjin nr. 9936, date 26.6.2008, “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, pika 6, 14 dhe 26, nenit 4, të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të kërkojen në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, shpërblimi i dëmit ekonomik në vlerën totale **12,353,792 lekë**, të shkaktuar buxhetit të shtetit si më poshtë

- Për shumën **480 lekë**, llogaritur më pak tatim suplementar;

- Për shumën **71,500 lekë**, për anëtar të KRRT-së;

- Për shumën **112,549 lekë**, për punë jashtë kohës normale të punës;

-Për shumën **64,649 lekë**, për punonjësit e administratës paguar padrejtësisht duke mos qenë në listë prezencën;

- Për shumën **981,960 lekë**, shpërblyer punonjësit e administratës me 50 % të pagës për vitin 2009;
- Për shumën **64,800 lekë**, për shpenzime trajnimi për trajnerin e ekipit të volejbollit;
- Për shumën **85,396 lekë**, për sigurimet shoqërore për trajnerin e volejbollit dhe shëndetësore detyrim i pa llogaritur;
- Për shumën **210,000 lekë**, pagesë e kryer pa kontratë;
- Për shumën **6,862,500 lekë**, për ekipin e futbollit Himarë, përfituar trajtim ekonomik në lekë;
- Për shumën **1,266,980 lekë**, shpenzime për udhëtim e dieta të punonjësve të administratës, ekipin e futbollit dhe ekipin e volejbollit;
- Për shumën **1,164,500 lekë**, shpenzime për udhëtim e dieta të punonjësve të administratës, ekipin e futbollit dhe ekipin e volejbollit;
- Për shumën **746,740 lekë**, për udhëtim e dieta të punonjësve të administratës, ekipin e futbollit dhe ekipin e volejbollit;
- Për shumën **353,754 lekë**, për shpenzime të telefonisë celulare;
- Për shumën **7,689 lekë**, si diferencë ndërmjet situacionit të punimeve dhe faturës së thjeshtë tatimore;
- Për shumën **23,715 lekë**, ngurtësuar më pak si detyrimi i përcaktuar në faturën e shitjes dhe situacionit përfundimtarë të punimeve;
- Për shumën **336,580 lekë**, llogaritur më shumë në faturën e shitjes, llogaritur gabim TVSH-ja.

Brenda Muajit Qershor 2013

2. Nga Bashkia Himarë të merren masa e të kërkohen në rrugë ligjore shpërblymimi i dëmit ekonomik në vlerën totale **6,656,166 lekë, të shkaktuar buxhetit të shtetit si më poshtë:**

a. Për vlerën 480,000 lekë ndaj personave [REDACTED] 160,000 lekë [REDACTED] 160,000 lekë dhe [REDACTED] 160,000 lekë për dëmin ekonomik si rezultat i skualifikimit të paargumentuar të operatorit ekonomik “Tec Konsulent” në prokurimin me objekt “Studim, projektim e rikonstruksion i rrugës së brendshme, KUZ, KUB, linja elektrike e telefon”.

Brenda Muajit Qershor 2013

b. Për vlerën 192,000 lekë, për personat Aleksandër Guma 64,000 lekë, [REDACTED] 64,000 lekë dhe [REDACTED] 64,000 lekë, si dëm i shkaktuar si rezultat i skualifikimit të paargumentuar të operatorit ekonomik “[REDACTED]” shpk në prokurimin e zhvilluar me objekt “Blerje automjeti”.

Brenda Muajit Qershor 2013

c. Për vlerën 51,906 lekë, për personat [REDACTED] 12,976.5 lekë, [REDACTED] 12,976.5 lekë, [REDACTED] 12,976.5 lekë dhe [REDACTED] 12,976.5 lekë për dëmin ekonomik të shkaktuar si rezultat i mosllogaritjes së saktë të kostos së çmimit për njësi të preventivit të fondit limit në prokurimin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i pastrimit të qytetit” në periudhën 22.01-31.03.2010.

Brenda Muajit Qershor 2013

d. Për vlerën 38,399 lekë, për personat [REDACTED] 9,599.75 lekë, [REDACTED] 9,599.75 lekë, [REDACTED] 9,599.75 lekë dhe [REDACTED] 9,599.75 lekë, për dëmin e shkaktuar si rezultat i mosllogaritjes së saktë të kostos së çmimit për njësi të preventivit të fondit limit dhe futjes bë këtë preventiv të zërit “Heqje mbeturinash voluminoze” në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, kreu II, neni 5 e 6, në prokurimin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i pastrimit dhe mirëmbajtjes së varrezave”, periudha 31.03.2010-30.06.2010.

Brenda Muajit Qershor 2013

e. Për vlerën 3,110,945 lekë, për personat [REDACTED] 622,189 lekë, [REDACTED] 622,189 lekë, [REDACTED] 622,189 lekë, [REDACTED] 622,189 lekë dhe [REDACTED] 622,189 lekë, si dëm i shkaktuar nga mosllogaritja e saktë e

kostos së çmimit për njësi të preventivit të fondit limit dhe futjes në këtë preventiv të zërit “Heqje mbeturinash voluminoze” . Ky veprim është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, kreu II, neni 5 e 6, në prokurimin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i pastrimit dhe mirëmbajtjes së varrezave”, periudha 30.06.2010-30.04.2011(ndërrerë kontrata me operatorin ekonomik fitues).

Brenda Muajit Qershor 2013

f. Për vlerën 2,719,175 lekë, për katër persona █████ 679,793.75 lekë █████ 679,793.75 lekë, █████ 679,793.75 lekë dhe █████ 679,793.75 lekë për dëmin e shkaktuar si rezultat i skualifikimit të paargumentuar të operatorit ekonomik “█████” shpk në prokurimin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i pastrimit dhe mirëmbajtjes së varrezave”.

Brenda Muajit Qershor 2013

g. Për vlerën 63,741 lekë, për personat █████ 31,870.5 lekë dhe █████ 31,870.5 lekë, për dëmin ekonomik të shkaktuar si rezultat i lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik fitues me vlerë më të madhe se fondi limit.

Brenda Muajit Qershor 2013

3. Të kontabilizohet dhe fillojë procedura ligjore për kërkimin e dëmit ekonomik në vlerën prej 1,111,276 lekë me TVSH ndaj subjektit “█████” sh.p.k, sa përfituar tepër në zbatimin e kontratës datë 19.05.2010, të punimeve në objektin “Ndërtimi i Shëtitores (pedonale) Spile, Himarë”, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Brenda Muajit Qershor 2013

4. Të bëhet kontabilizimi dhe të fillojë procedura ligjore për arkëtimin e shumës së dëmit ekonomik prej 5,332,306 lekë, për 47 raste, të shkaktuara nga shkelja e moszbatimi i nenit 51 paragrafi dytë i ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998, i ndryshuar me ligjin nr. 10078, datë 16.02.2009, neni 9.

Deri me datë 30.6.2013

5. Të bëhet kontabilizimi dhe të fillojë procedura ligjore për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën prej 1,190,134 lekë ndaj subjektit ndërtues subjektit ndërtues “█████”, si rezultat i llogaritjes më pak të sipërfaqes ndërtimore për 1034 m² dhe mos arkëtimin të tarifës prej 4%, rezultuar sipas procesverbalit të verifikimit në vend datë 10.10.2012, në kundërshtim me nenin 51 ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”.

Deri me datë 30.6.2013

6. Të bëhet kontabilizimi dhe të fillojë procedura ligjore për arkëtimin e taksës së tokës bujqësore të paarkëtuar në masën 400,000 lekë ndaj personave të pajisur me leje ndërtimi, përcaktuar në listën nr. 8/4 mosveprim në kundërshtim me Rregulloren e ZQRPP, nr. 61, datë 02.8.2999.

Deri me datë 30.6.2013

7. Nga Bashkia të kontabilizohen dhe të fillojnë procedurat ligjore për arkëtimin e gjobave të vendosura nga INUV për 33 raste në vlerën prej 2,240,000 lekë që i përkasin periudhës viteve 2009-2011, mosveprim në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”.

Deri me datë 30.6.2013

8. Të merren masat, nga Bashkia Himarë dhe të ndiqen procedurat në rrugë ligjore, për arkëtimin e vlerës (shpërblimin e dëmit) prej **229,550 lekë**, të shkaktuar buxhetit të shtetit nga 2 persona

përgjegjës, përkatësisht [REDAKTUAR] si rezultat i aplikimit të tarifave të gabuara në kontratat e lidhura për dhënien me qera të kullotave dhe livadheve.

Brenda muajit Mars 2013

C. MASA ADMINISTRATIVE

Bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 15, ndryshuar me nenin 2 të ligjit nr. 9826, datë 01.11.2007 dhe ligjin nr. 11/2012, datë 9.2.2012 për shkëlqje të neneve, 4,5, 7 dhe 12; pikat 7, dhe 7/1, të kreut I-^{rë}, të UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, **i propozohet: Kryeinspektorit të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik, pranë Bashkisë Himarë, që të ndëshkojë administrativisht duke aplikuar gjobë për personat e mëposhtëm:**

1. [REDAKTUAR], në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, **gjobë në masën 100,000 lekë**, pasi në objektin “Ndërtimi i Shëtitorës (pedonale) Spile, Himarë”, ka lejuar të situacionohen punime të pa kryera në fakt.

2. [REDAKTUAR], në cilësinë e projektuesit në objektin “Ndërtimi i Shëtitorës (pedonale) Spile, Himarë”, **gjobë në masën 100,000 lekë**, pasi ka paraqitur për zbatim projektin e zbatimit dhe preventivin e punimeve jo të plotë.

3. [REDAKTUAR], në cilësinë e preventivuesit të punimeve, **gjobë në masën 100,000 lekë**, pasi në objektin “Ndërtimi i Shëtitorës (pedonale) Spile, Himarë” nuk ka preventivuar me çmime për njësi sipas Manualeve të Preventivimit të Punimeve të Ndërtimit të miratuara me VKM nr. 30, datë 20.01.2010.

4. [REDAKTUAR], në cilësinë e preventivuesit të punimeve, **gjobë në masën 100,000 lekë**, pasi në objektin “Ndërtimi i Shëtitorës (pedonale) Spile, Himarë”, nuk ka preventivuar me çmime për njësi sipas Manualeve të Preventivimit të Punimeve të Ndërtimit të miratuara me VKM nr. 30, datë 20.01.2010.

5. [REDAKTUAR], në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, **gjobë në masën 100,000 lekë**, pasi në objektin “Ndërtimi i Shëtitorës (pedonale) Spile, Himarë”, ka lejuar të situacionohen punime të pa kryera në fakt.

6. [REDAKTUAR], në cilësinë e kolaudatores së punimeve, **gjobë në masën 100,000 lekë**, pasi në objektin “Ndërtimi i Shëtitorës (pedonale) Spile, Himarë” ka lejuar situacionimin e punimeve të pa kryera në fakt.

Ç. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në germën “b” dhe “d” të nenit 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, kërkojmë nga Kryetari i Bashkisë, që të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore:

I. “Largim nga shërbimi civil”.

1. **zj.** [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjëse e Financës dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit të pasurisë publike dhe të asgjësimit të materialeve në 19 raste;

-Për të meta e mangësi, të konstatuara në punën e kryer prej saj për periudhën e audituar në shkelje të legjislacionit në fuqi, trajtuar më hollësisht në procesverbalin nr. 21, datë 01.11.2012, nr. 23, datë 01.11.2012, nr. 24, datë 31.10.2012, nr. 25, datë 31.10.2012, nr. 26, datë 01.11.2012 dhe nr. 29, datë 01.11.2012.

2. [REDAKTUAR] me detyrë auditues i brendshëm në Zyrën e Auditimit

- Për të meta e mangësi të konstatuara në punën e kryer prej tij për periudhën e audituar në shkelje të legjislacionit në fuqi, moszbatim të planit të auditimeve për vitin 2011, moszbatimin e standardeve dhe procedurave të kryerjes së auditimeve, mosevidentimin e gjetjeve, që ka sjellë si pasojë mungesën e efikasitetit dhe efektivitetit të auditimit të brendshëm që vjen në kundërshtim me ligjin nr. 9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, të ndryshuar, më hollësisht trajtuar në procesverbalin nr. 5, datë 01.10.2012 dhe në aktverifikimin nr. 2, datë 1.10.2012.

II. Mbështetur në nenin 141, 144 pika 2 dhe neni 153 pika 1, 2 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, dhe kontratës individuale të punës, t’i kërkoj Kryetarit të Komunës, të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore për personat si më poshtë;

“Vërejtje me paralajmërim për Zgjidhjen e kontratës së punës”.

1. zj. [REDAKTUAR] me detyrë specialiste informacioni, në cilësinë e anëtarit të komisionit për blerjet me vlera të vogla në 7 raste;

-Për të meta e mangësi, mbi zbatimin e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. zj. [REDAKTUAR] me detyrë arkëtare, në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit të pasurisë publike dhe të asgjësimit të materialeve në 5 raste;

-Për të meta e mangësi, mbi zbatimin e ligjit nr. 6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, VKM nr. 70, datë 11.03.1985 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, Udhëzimin nr. 1151, datë 16.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë Brendshme”.

III. Për të meta dhe mangësitë dhe shkeljet e konstatuara, të trajtuara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, për ish-punonjësit:

Për [REDAKTUAR] me detyrë ish-Drejtor Ekonomik, [REDAKTUAR] me detyrë ish/nënkryetar Bashkie, [REDAKTUAR] me detyrë inspektor në Drejtorinë e Shërbimeve, [REDAKTUAR] me detyrë inspektor në Drejtorinë e Tatim Taksave, [REDAKTUAR] me detyrë ish-specialiste në Drejtorinë e Urbanistikës, do të rekomandonim dhënien e masës **“Largim nga shërbimi civil”**.

Për [REDAKTUAR] me detyrë ish-specialist hidraulik, [REDAKTUAR] me detyrë ish-operatore dhe në cilësinë e anëtarit të komisionit të inventarizimit të pasurisë publike; [REDAKTUAR], me detyrë ish -specialiste e zyrës protokoll arshivës, [REDAKTUAR] me detyrë ish-operatore, dhe [REDAKTUAR] me detyrë ish-polic, do të rekomandonim dhënien e masës **“Zgjidhje të kontratës së punës”**.

Meqenëse nuk janë në marrëdhënie pune, nuk është mundësia e rekomandimit të dhënies së këtyre masave nga institucioni.

D. KALLËZIM PENAL

1. Ndaj: Z. [REDACTED], me detyrë ish-Kryetar i Bashkisë Himarë,
Z. [REDACTED], në cilësinë e ish-Sekretarit të Sekretarisë Teknike, dhe
Z. [REDACTED], në cilësinë e ish-Drejtorit të Drejtorisë së Urbanistikës, dhe në cilësinë e ish-Sekretarit të KRRT-së së Bashkisë, (1.11.2010-30.6.2011).

Për: Konsumimin e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse, pasi:

Nga auditimi janë konstatuar një sërë shkeljesh të dispozitave ligjore në fushën e urbanistikës, të cilat nën këndvështrimin e grupit të auditimit përmbajnë elementët e figurës së veprës penale, dhe më konkretisht:

- Nga auditimi i kryer në **fushën e urbanistikës**, ka rezultuar që në plotësimin e formularit nr. 2 që i përket “Lejes së Sheshit” dhe formularit nr. 4 që i përket “Lejes Ndërtimit”, është vepruar pa patur paraprakisht Studim Urbanistik Rajonal dhe Mjedisor të miratuar nga KRRT-ja për rastet e ndërtimit të objekteve të banimit e shërbimit në territoret nën juridiksionin e Bashkisë Himarë.

- Studimet Urbanistike Pjesore, për të gjitha rastet e miratimit të tyre, janë të njëjta me planimetritë e një sheshi të ndërtimit, pa u shënuar numri dhe data e vendimit të miratimit nga KRRT-ja dhe pa relacion arkitektonik, veprime këto që bien ndesh me kërkesat e Ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën” i ndryshuar, neni 20, pika 2, gërma “dh”, e cila shprehet se SUP-të hartohen në zberthim dhe zbatim të master planeve të miratuara dhe kërkesave të VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”, pikat 4, 43-48.

- Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se për 22 raste, lejet e ndërtimit janë shqyrtuar dhe miratuar mbas 6 muajve nga vendimi për miratimin e lejes së sheshit të ndërtimit, veprim ky në kundërshtim me nenin 46 të Ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i **cili shprehet:**

“Nga data e miratimit të destinacionit të funksionit dhe të kushteve urbanistike të sheshit të ndërtimit, deri në paraqitjen e kërkesës për leje ndërtimi Për rastet e territoreve pronë private afati kohor i vendimit të KRRT-së për miratimin e destinacionit të funksionit të sheshit të ndërtimit dhe të kushteve urbanistike të tij, pavarësisht nga sipërfaqja, është 6 muaj. Në rast se ky afat kohor kalohet kërkesa ripërtërihet. Kur shkelen afatet për vendimin e sheshit të ndërtimit, si për territorin pronë private dhe ato pronë publike, vendimi i KRRT-së bëhet i pa vlefshëm”.

- Nga auditimi rezultoi gjithashtu që për 59 raste, janë pranuar kërkesa për miratim të lejes së sheshit dhe lejes të ndërtimit pa dokument pronësie të lëshuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, por vetëm mbi bazën e formularit nr. 6, Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP) apo vendimit të gjykatës për njohje të faktit juridik të pronësisë në emër të kërkuarëve në zërat kadastral “arë”, “ullishtë”, “pemëtore”, etj., veprime këto të kryera në kundërshtim me Ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën” i ndryshuar, nenet 40 dhe 85.

- Nga 59 rastet e mësipërme, në 7 prej tyre sipas protokollit të KRRT-së datë 16.12.2010, në vendin e quajtur “Gonia”, Dhërmi, janë miratuar 7 leje sheshi dhe 7 leje ndërtimi duke u bazuar në bashkimin e sipërfaqeve të 2 AMTP-ve ($5000\text{ m}^2 + 4390\text{ m}^2 = 9390\text{ m}^2$) dhe përkatësisht, AMTP nr. 9835, datë 7.02.1994 dhe AMTP nr. 9715/1, datë 7.02.1994.

- Mbi bazën e sipërfaqes së pasqyruar nga bashkimi i këtyre 2 AMTP-ve të mësipërme (9390 m^2), janë edhe 7 lejet e sheshit dhe të ndërtimit po me këtë sipërfaqe 9390 m^2 ku në fakt sipërfaqja reale duhet të ishte 7390 m^2 .

- Nga auditimi rezultoi që është ndërhyrë në sipërfaqet reale të pasqyruara në AMTP nr. 9835, datë 7.02.1994, duke falsifikuar shifrën e mëparshme 3000 m^2 në 5000 m^2 .

Kjo vërtetohet edhe në rast se bëhen përlllogaritjet e shumave totale të sipërfaqeve të pasqyruara në formularin nr. 6 dhe AMTP nr. 9835, datë 7.02.1994.

Si rrjedhojë e këtij falsifikimi është shtuar artificialisht sipërfaqja totale e pasqyruar në këto 2 AMTP dhe për rrjedhojë është shtuar edhe sipërfaqja totale e pasqyruar në lejet e sheshit dhe të ndërtimit veprime këto të kryera për të rritur artificialisht koeficientin e shfrytëzimit të këtyre ndërtimeve.

- Gjithashtu, në disa raste janë miratuar leje sheshi dhe leje ndërtimi në emër të kërkuesve trashëgimtarë të poseduesve të AMTP-ve, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 207 të Kodit Civil, Ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”, neni 40, si dhe Ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” i ndryshuar, neni 22 “Kalimi i pronësisë së një pjesë të pasurisë së paluajtshme”, i cili parashikon:

“Asnjë pjesë në natyrë të pasurisë së paluajtshme të përfshirë në një kartelë nuk kalohet në pronësi tjetër në qoftë se pronari nuk e ka ndarë pasurinë e paluajtshme më parë në përputhje me ligjin, dhe në qoftë se nuk janë hapur kartela të reja për çdo nënndarje të pasurisë së paluajtshme”.

Për më tepër, këto AMTP nuk janë të regjistruara në ZVRPP Vlorë dhe si rrjedhojë kërkuesit e këtyre lejeve të sheshit dhe të ndërtimit nuk kanë asnjë titull pronësie.

(Argumentimi më i plotë i kësaj çështje trajtohet në procesverbalin nr. 32 datë 22.10.2012, faqe 5, 6, 9, 13, 14 dhe 16; procesverbalin nr. 33 datë 23.10.2012, faqe 6–16, si dhe procesverbalin nr. 34 datë 24.10.2012, faqe 3 – 10, bashkëlidhur këtij kallëzimi)

- Gjithashtu, nga auditimi rezultoi që për 8 raste të miratimit të kërkesave për leje sheshi dhe leje ndërtimi me dokumente pronësie “Kontratë shitje trualli” lëshuar nga Seksioni i Financës, Bashkia Himarë.

- Kontratat e shitjes së truallit janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, neni 3, ndërsa dhënia e lejeve të ndërtimit nga KRRT e Bashkisë Himarë, mbi bazën e këtyre kontratave të shitjes së truallit është bërë në kundërshtim me formatin e Formularit nr. 1, “Kërkesë për miratimin e destinacionit dhe kondicioneve urbane të sheshit të ndërtimit”, i cili kërkon shprehimisht që apkuesit në kërkesën e bërë për miratimin e sheshit të ndërtimit duhet të paraqesin dokumentin e pronësisë për pronësinë private nga zyra e hipotekës (aktualisht ZVRPP, Vlorë). Formulari nr. 1 është pjesë integrale e Ligjit. nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar përcaktuar në nenin 85.

- Gjithashtu, nga auditimi rezultoi se nuk janë zbatuar kërkesat e nenit 51 të Ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar, për arsye se autorizimet për pagesën e taksës së infrastrukturës të plotësuar nga Sekretaria Teknike nuk mbajnë datë plotësimi dhe për rrjedhojë nuk janë kryer llogaritjet e kamat vonesave për pagesat e kryera më vonë se 30 ditë nga data e lëshimit të autorizimeve.

- Drejtoria e urbanistikës ka bërë zbardhjen e lejeve të ndërtimit, pa u bërë më parë arkëtimi i tarifës së taksës së ndikimit në infrastrukturë në afatin brenda 30 ditëve të punës, dhe si rrjedhojë për 47 raste të verifikuara nuk është llogaritur një vlerë totale prej 5,332,306 lekë dhe në 1 rast tjetër nuk është llogaritur sipërfaqja e saktë duke rezultuar në një diferencë më vlerë prej 1,190,134 lekë siç trajtohet edhe në procesverbalin nr. 32, datë 22.10.2012 bashkëlidhur këtij kallëzimi.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën”, neni 51.

- Nga auditimi ka rezultuar gjithashtu që në disa raste janë miratuar leje ndërtimi mbi bazën e AMTP-ve, ku përfituesit nuk kanë paguar paraprakisht taksën e tokës bujqësore në shumën 400,000 lekë, që përbën dëm ekonomik, pasi është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

- Gjithashtu nga auditimi ka rezultuar që për 2 raste të ndërtimeve pa leje, nga ana e KRRT- së Bashkisë Himarë, është dhënë leje ndërtimi në një kohë që këto 2 objekte kanë qenë të përfunduara (ndërtim pa leje) para marrjes së lejes së ndërtimit.

Njëkohësisht në formularët nr. 4 të këtyre lejeve të ndërtimit, dhe përkatësisht në Vendimin e

KRRT-së për Leje e Ndërtimi nr. 111, datë 16.12.2010, dhe atë nr. 18/1 datë 6.3.2009, në rubrikën “Subjekti Ndërtues” në vend të vendosjes së emrit të subjektit është shënuar fjala “Legalizim” duke nënkuptuar që së bashku me dhënien e lejes së ndërtimit është bërë edhe legalizimi i këtyre objekteve.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, neni 38/1 “Legalizimi i

ndërtimeve pa leje në territoret me përparësi zhvillimin e turizmit” dhe Ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën” i ndryshuar, neni 77.

- Në dhënien e lejeve të shfrytëzimit për 17 praktika rezultoi se mungojnë dokumentet e pronësisë, dhe dokumente të tjera si fotografi të fasadave të objektit, fletë A-4; relacioni gjeologjik; deklarata e pastërtisë nga Inspektorati i Mjedisit; Vërtetim nga Drejtoria

Rajonale e Tatimeve për shlyerjen e detyrimeve tatimore sipas situacionit përfundimtar, veprime këto të kryera në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar.

- Gjithashtu, nga auditimi ka rezultuar që ish-Kryetari i Bashkisë Himarë z. Vasil Bollano, për periudhën që ka drejtuar nga viti 2008 deri më 30.06.2011, nuk ka menaxhuar, ka lejuar shkelje, nuk ka llogaritur dhe nuk ka vepruar për arkëtimin e detyrimeve në tatim-taksat për periudhën objekt auditimi në shumën totale prej 87,783,240 lekë, si taksë nga ndërtesat, taksë për tokën, taksë hoteli dhe taksë për zënie hapësire publike.

- Njëkohësisht nga auditimi ka rezultuar që ish-Kryetari i Bashkisë Himarë, nuk ka zbatuar dhe ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme në refuzimin e paargumentuar të rekomandimeve të KLSH-së, të dërguara me shkresën nr. 187/4 datë 26.03.2008, shkresën nr. 372/6, datë 29.3.2010, dhe të rikërkua me shkresën nr. 372/17, datë 22.10.2010, duke mos i dërguar Agjencisë së Prokurimit Publik rekomandimet e iniciuara nga KLSH, gjë që ka sjellë si pasojë mos arkëtimin dhe mos kërkimin në rrugë ligjore të dëmit të shkaktuar buxhetit të shtetit nga keqmenaxhimi i njësisë vendore, me vlerën 22,235,224 lekë.

Si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të mësipërme penale dhe shkeljeve të tjera të legjislacionit në fuqi, KLSH ka konstatuar një dëm ekonomik në vlerën **40, 753,136 lekë** dhe të ardhura të munguara nga mosarkëtimi i taksave lokale në vlerën 87,783, 240 lekë

Sa trajtuar më sipër në miratimin e lejeve të sheshit të ndërtimit dhe lejeve të ndërtimit, pa titull pronësie dhe me mungesa të tjera në dokumentacion vlerësojmë se veprimet e kryera janë në kundërshtim me nenin 50/1, të Ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar i cili shprehet:

"Kalimi për miratim i lejes së ndërtimit, qoftë edhe nëpërmjet heshtjes, në shkelje të kushteve urbanistike për dhënien e lejes së ndërtimit, të parashikuara në këtë ligj, përbën mospërmbyllje të rregullt të detyrës.

Shkelja me dashje e dispozitave për kalimin për miratim të lejes së ndërtimit, qoftë edhe nëpërmjet heshtjes, passjell përgjegjësi penale, sipas ligjit."

Për të gjitha shkeljet e konstatuara më sipër, mbajnë përgjegjësi [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-Kryetarit të Bashkisë Himarë dhe ish-Kryetarit të KRRT-së së kësaj bashkie, [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-Drejtorit të Drejtorisë së Urbanistikës dhe ish-Sekretarit të KRRT-së së Bashkisë Himarë, si dhe [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-Sekretarit të Sekretarisë Teknike të Bashkisë Himarë, të cilët në

mospërmbushje të rregullt të detyrës së tyre funksionale dhe në shkelje të dispozitave të mësipërme ligjore, kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

2. Ndaj: Z. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish-juristit të Njesisë së Prokurimit,
Z. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish-specialistit të Njesisë së Prokurimit,
Zj. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish-specialistes të Njesisë së Prokurimit,
Z. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish-Drejtorit të Shërbimeve dhe preventivuesit.

Për: Konsumimin e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i Ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse.

3. Ndaj: Z. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish-juristit të Njesisë së Prokurimit,
Z. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish-Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,
Z. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish-anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, dhe
Z. [REDAKTUAR], në cilësinë e ish-anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për: Konsumimin e figurës së veprës penale të “Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, të parashikuar nga neni 258 i Ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse.

a. Nga auditimi kanë rezultuar një sërë shkeljesh ligjore në lidhje me zbatimin e procedurave të prokurimit, si më poshtë:

- Në procedurat e prokurimit elektronik, me objekt “Për shërbimin e pastrimit dhe mirëmbajtjes së varrezave të qytetit”, me urdhër prokurimi nr. 250 prot., datë 03.03.2010, rezultoi se fondi limit prej 11,166,086 lekë (pa TVSh) i vendosur nga Autoriteti Kontraktor për periudhën nga data 30.6.2010 deri më datë 30.6.2011, është i pasaktë sepse nga analiza e hartimit të kostove të çmimeve për njësi, të zërave të punës të vendosura në preventivin e fondit limit, rezultoi se sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punëdhënësit në këto analiza janë llogaritur në masën 30.7% mbi pagën bruto, në një kohë ku sipas VKM nr. 700, datë 18.06.2009 ato duhej të ishin llogaritur në masën 16.7%.

- Struktura e kostos dhe e ardhura neto janë llogaritur veçmas mbi shpenzimet direkte, ku si rregull duhet të llogariteshin së bashku mbi këto shpenzime, kërkesë kjo e UKM nr. 2 datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu II “Struktura e kostos së punimeve të ndërtimit”, shembulli 1 “Analiza teknike”.

- Gjithashtu, në preventivin e zërave të punimeve të këtij fondi është vendosur edhe zëri i punimeve “Heqje e mbeturinave voluminoze”, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, Kreun II, neni 5 “Mbeturina” dhe neni 6 “Përrjashtime”.

- Si rezultat i këtyre veprimeve të kundërligjshme, të cituara më sipër, është krijuar një dëm ekonomik në buxhetin e bashkisë në vlerën 3,110,945 lekë (me TVSh) **dhe më konkretisht:**

- Fondi limit i llogaritur nga Autoriteti Kontraktor për periudhën (30.6.2010 – 30.6.2011) është 13,399,304 lekë (me TVSh), ndërsa fondi limit i llogaritur nga grupi i auditimit për periudhën (30.6.2010-30.6.2011) pa zërin “Heqje mbeturina voluminoze”, është 11,600,140 lekë (me TVSh). Si rrjedhojë, kontrata e lidhur me firmën fituese, në vlerën

13,399,303 lekë (me TVSh), rezulton me një diferencë më të madhe se sa fondi limit (me TVSh) i llogaritur nga grupi i auditimit në vlerën 1,799,263 lekë (13,399,303 lekë - 11,600,140 lekë).

- Për sa i përket fondit limit të llogaritur nga Autoriteti Kontraktor për periudhën (30.6.2011 –

30.4.2012) në vlerën 11,170,886 lekë (me TVSh); fondi limit i llogaritur nga grupi i auditimit për periudhën (30.6.2011-30.4.2012) pa zërin “Heqje mbeturina voluminoze” është 9,671,583 lekë (me TVSh). Si rrjedhojë, kontrata e lidhur me firmën fituese, në vlerën 10,983,365 lekë (me TVSh), rezulton me një diferencë më të madhe se sa fondi limit (me TVSh) i llogaritur nga grupi i auditimit në vlerën 1,311,782 lekë (me TVSh) (10,983,365 lekë - 9,671,583 lekë). Kjo kontratë është ndërprerë nga Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 792, datë 23.04.2012.

Për shkeljet e konstatuara më sipër, mbajnë përgjegjësi [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-juristit të Njesisë të Prokurimit, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-specialistëve të Njesisë së Prokurimit, si dhe [REDAKTUAR] në cilësinë e ish-drejtorit të shërbimeve dhe në cilësinë e preventivuesit, të cilët nëpërmjet veprimeve të tyre të kundraligjshme u kanë sjellë personave të tjerë përfitime të padrejta dhe kanë dëmtuar interesat e ligjshme të shtetit duke konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga nenin 248 i Kodit Penal.

b. Gjithashtu, në procedurat e prokurimit të mësipërm ku nga grupi i auditimit është përlogaritur një dëm ekonomik në vlerën 2,719,175 lekë (me TVSh), rezultuan një sërë shkeljesh si më poshtë:

- Dokumentet e tenderit të ndodhura në këtë dosje nuk janë të firmosura nga Njësia e Prokurimit. Po ashtu i pa firmosur është edhe procesverbali i hartimit dhe miratimit të tyre, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreut V, pika 2, shkronja “a”, të ndryshuar.

- Në dosje mungon i gjithë dokumentacioni administrativo-ligjor, ekonomik e financiar i operatorit ekonomik “[REDAKTUAR]” shpk, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 10.11.2006 “Për prokurimin publik”, Kreun II, neni 12, i ndryshuar.

- Në kontrollin elektronik të bërë këtij prokurimi, duke klikuar skedarin “Zyrtarët e prokurimit”, rezulton se me hartimin e dokumenteve të këtij prokurimi është marrë vetëm juristi i NJP, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu V, pika 1, shkronja “a”, të ndryshuar.

- Në dosjen e këtij prokurimi mungojnë dokumentet e tenderit, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu V, pika 1, shkronja “a” dhe “c”, pika 2, shkronja “a”, të ndryshuar.

- Në dosje mungon procesverbali mbi zhvillimin e procedurës së hapjes dhe të vlerësimit të ofertave të këtij prokurimi, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu V, pika 4, shkronja “i”, të ndryshuar.

- Raporti përmbledhës i hartuar më datën 29.04.2010, mbi klasifikimin përfundimtar të operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë prokurim është firmosur nga një anëtar i KVO-së, veprim ky në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu V, pika 4, shkronja “gj”, të ndryshuar.

Sipas raportit përmbledhës, datë 29.04.2010, në këtë prokurim kanë marrë pjesë operatorët ekonomik “[REDAKTUAR]” shpk, “[REDAKTUAR]”, “[REDAKTUAR]” shpk, “[REDAKTUAR]” shpk, dhe “[REDAKTUAR]” shpk.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, KVO ka s’kualifikuar me të drejtë operatorët ekonomik “[REDAKTUAR]” shpk me ofertë 9,940,086 lekë (pa TVSh) dhe “[REDAKTUAR]” me ofertë 10,104,534 lekë (pa TVSh) dhe pa të drejtë operatorin ekonomik “[REDAKTUAR]” shpk, me ofertë 8,717,387 lekë (pa TVSh). Operatorët e tjerë ekonomik të kualifikuar nga KVO-ja janë “[REDAKTUAR]” shpk, me ofertë 10,983,366 lekë (pa TVSh) dhe “[REDAKTUAR]” shpk, me ofertë 11,139,497 lekë (pa TVSh).

- Operatori ekonomik “[REDAKTUAR]” shpk, është s’kualifikuar nga KVO për **shkaqet e mëposhtme:**

- Nuk ka shërbime të ngjashme të mirëmbajtjes së varrezave pasi në DST është përcaktuar se *“Shërbime të së njëjtës natyrë me një vlerë 3,000,000 lekë pa TVSh për shërbimin e pastrimit dhe 200,000 lekë për shërbimin të mirëmbajtjes së varrezave publike të realizuara gjatë 3 viteve të fundit të aktivitetit të operatorit”*.

- Kontrata e paraqitur e lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor dhe Bashkisë Bilisht është një

kontratë e lidhur me datën 12.05.2009 me afat 2 vjeçar por nga KVO kjo kontratë

është konsideruar si e pambyllur dhe nuk është marrë në konsideratë.

- Mungon grafiku i shërbimeve, metodologjia, etj, pasi në DST është përcaktuar “*Dokumente që lidhen me objektin e prokurimit, specifikime teknike, metodologjinë e punës, broshura, grafikun e punimeve*”.

- Nga shoqëria “██████████*” shpk është paraqitur një dokument që titullohet “*CV stafit*” dhe në përmbajtjen e saj përcaktohet emri i drejtuesit të shoqërisë dhe emrat e dy punëtorëve. Nga ana e ofertuesit nuk janë realizuar kërkesat e përcaktuara në DST.

“*Operatori ekonomik duhet të përcaktojë drejtuesin e shërbimit të pastrimit të qytetit të Himarës nëpërmjet një deklaratë nga ana e administratorit të shoqërisë.*

Drejtuesi teknik ose personi përgjegjës që do të merret me këtë objekt duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet të vërtetuara në CV e personit përgjegjës.

Për stafin kryesor që është punësuar pranë operatorit ekonomik, të paraqiten kontratat e punës së vlefshme për ato ekspertë që nuk i përkasin dpt, operatorit ekonomik, të paraqiten deklaratat e disponueshme për ekzekutimin e kontratës.

- Nga auditimi rezultoi se operatori ekonomik “██████████” shpk kishte sjellë CV e drejtuesit ligjor me arsim të lartë agronomi si dhe kishte sjellë në rrugë elektronike një kontratë për pastrimin e zonës turistike të komunës Golem, me vlerë 8,399,462 lekë me kohëzgjatje nga data 04.01.2008 deri më 03.01.2009, por kjo kontratë nuk është përfshirë në Raportin Përfundimtar nga KVO. Si rrjedhojë operatori ekonomik “██████████” shpk, nuk duhej të ishte s’kualifikuar.

- Nga auditimi i dokumentacionit ligjor dhe tekniko-ekonomik në rrugë elektronike, rezultoi se operatori ekonomik fitues “██████████” shpk, është favorizuar për faktin se Njësia e Prokurimit në hartimin e kërkesave për kualifikim të përcaktuara në shtojcën 5 të DST si dhe në procesverbalin e hartimit dhe të miratimit të këtyre kërkesave i është shmangur në disa raste kërkesave të përcaktuara në Kreun III, pika 3, shkronja “c”, “Kontrata e shërbimeve”, për t’iu përshtatur kërkesave që plotëson në këtë prokurim operatori ekonomik “██████████” shpk.

- Sipas pikës “c” të VKM të sipërcituar, AK mund të kërkojë dëshmi të shërbimeve të mëparshme të kryera gjatë tre viteve të fundit financiare. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- Nga Njësia e Prokurimit në dokumentet standard të tenderit është vendosur vlera 3,000,000 lekë (pa TVSh) për shërbimin e pastrimit e qytetit dhe 200,000 lekë (pa TVSh) për mirëmbajtjen e varrezave, gjithsej 3,200,000 lekë (pa TVSh).

- Vlera e llogaritur e kontratës që prokurohej ishte 10,834.608 lekë (pa TVSh) për shërbimin e pastrimit dhe 331,478 lekë (pa TVSh) për mirëmbajtjen e varrezave, ku në fakt duhej të ishte 4,333,848 lekë (pa TVSh) për shërbimin e pastrimit dhe 132,591 lekë (pa TVSh) për mirëmbajtje varreza, gjithsej 4,466,434 lekë (pa TVSh).

Si rrjedhojë është kërkuar më pak se 40% i fondit limit që prokurohet në shumën 1,266,434 lekë (pa TVSh), kjo për faktin sepse operatori ekonomik “██████████” shpk ka realizuar kontrata të ngjashme afërsisht me shumën e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet standard të tenderit në 6-mujorin e dytë të vitit 2009 me kontrata të lidhura pa prokurim dhe me prokurim me negociim me autoritetin kontraktor, Bashkia Himarë.

Sipas pikës 1, shkronja “c” të VKM nr 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar, për kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorëve ekonomik duhej t’iu kërkohej Licenca profesionale për realizimin e punimeve objekt i kontratës, kërkesë kjo që nuk është vendosur nga AK në

DT: “*Kualifikimet arsimore dhe profesionale të stafit përgjegjës për drejtimin e punëve, kërkesë kjo e cila nuk është vendosur*”.

“*Dëshmi për fuqinë mesatare punëtore të operatorit ekonomik dhe për numrin e stafit drejtues deri në 3 vitet e fundit*”.

Një kërkesë e tillë është vendosur vetëm për 6-mujorin e dytë të vitit 2009, ku kërkohej mesatarisht 10 punëtorë në muaj, duke iu përshtatur kriterit që plotësonte operatori ekonomik “██████████” shpk për këtë shërbim, sipas koston për njësi të zërave të punës të preventivit të fondit limit të këtij prokurimi, kosto këto të përgatitura nga autoriteti kontraktor për kryerjen e këtij shërbimi ku duhej mesatarisht 16 punëtor në muaj.

Sipas kërkesë të shkronjës “c” të VKM të sipërcituar, autoriteti kontraktor mund të kërkojë një listë të personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar kontratën. *Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV e tyre dhe licencat profesionale kur kanë të tilla.* Nga AK në lidhje me këtë, është kërkuar që operatori ekonomik duhet të përcaktojë drejtuesin teknik të shërbimit të pastrimit nëpërmjet një deklaratë nga ana e administratorit të shoqërisë si dhe drejtuesit teknik ose personin përgjegjës që do të merret me këtë objekt duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet të vërtetuar me CV e personit përgjegjës.

KVO, gjatë hapjes dhe vlerësimit të ofertave, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu V, pika 4, të ndryshuar, pasi operatori ekonomik fitues “██████████” shpk, duhej të s’kualifikohej për mungesa në dokumentacion **si më poshtë:**

- Vërtetimi i bankës është jashtë afatit ligjor pasi ai mban datën 19.03.2010, ndërkohë që tenderi është zhvilluar me datën 31.03.2010, pasi në DST, pika II/a/c është kërkuar “*Një certifikatë të gjendjes financiare nga një ose më shumë banka në vlerën 10% të fondit limit të lëshuar jo më shumë se 5 ditë përpara ditës së hapjes së ofertave*”.

- Mungon mjeti autobot për të kryer shërbimin e larjes së qytetit sepse kontrata e marrjes me qira të këtij autoboti nga qiradhënësi ██████████ ka përfunduar me datën 01.06.2010, pra 30 ditë përpara lidhjes së kontratës.

- Mungon mjeti fadrom si dhe makina fshirëse e rrugës nuk ka leje qarkullimi.

- Mungon deklaratë për drejtuesin e shërbimit të pastrimit të qytetit të bërë nga administratori i shoqërisë dhe CV e drejtuesit teknik dhe e stafit kryesor përgjegjës.

- Eksperiencë e drejtuesit teknik dhe ligjor është 1 vit nga 5 vite që kërkohej.

- Mungon metodologjia e punës, broshura, etj, të kërkuara në specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit.

Përfundimisht rezulton se në këtë prokurim **ka patur pabarazi, mungesë transparence dhe favorizim i operatorit ekonomik fitues**, për të cilat ngarkohen me përgjegjësi juristi i Njesisë së Prokurimit i cili është marrë me hartimin e DT, nëpërmjet përcaktimit të kërkesave specifike për kualifikim të dokumenteve të këtij tenderi duke bërë të mundur favorizimin e operatorit ekonomik “██████████” shpk; si dhe anëtarët e KVO-së të cilët nuk kanë vlerësuar konform dispozitave ligjore në fuqi dokumentacionin ligjor-administrativ dhe tekniko-ekonomik të operatorit ekonomik të kualifikuar “Kabuci” shpk, si dhe të operatorit ekonomik të s’kualifikuar “██████████” shpk.

Për të gjitha shkeljet e konstatuara më sipër, mbajnë përgjegjësi ██████████ në cilësinë e ish-juristit të Njesisë së Prokurimit, ██████████ në cilësinë e ish-Kryetarit të KVO, ██████████ dhe ██████████ në cilësinë e ish-anëtarëve të KVO, të cilët kanë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të “**Shkeljes së barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike**”, të parashikuar nga neni 258 i Ligjit nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Selfo Zeneli, Qemal Shehu, Ramadan Zejnuni, Evis Kreshpaj, Mirosh Bogdo dhe Mina Blushi. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Bajram Lamaj, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT